

BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Dhjetor 2023

Përmbajtja:

- Një dekadë ndërgjegjësimit për sigurinë online të fëmijëve
- “Politikat e Sigurisë Kibernetike dhe Menaxhimi i Krizës” për Institucionet e Pavaruara, Sektorin UK, AKSHI dhe Policinë e Shtetit.



Një dekadë ndërgjegjësimit për sigurinë online të fëmijëve

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike fokusuar në implementim e politikës strategjike për rritjen e sigurisë së fëmijëve në hapësirën kibernetike, organizoi në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare International Telecommunication Union (ITU), datën 6 dhjetor workshop-in me temë “Një dekadë ndërgjegjësimit për sigurinë online të fëmijëve.”

Ky workshop u realizua në kuadër të përmbylljes së një projekti dy vjeçar iniciuar në shtator 2021 deri në dhjetor 2023, ku qëllimi kryesor është krijimi i një hapësirë kibernetike të sigurt për fëmijët përmes rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit me trajnime të shumta dhe fushatave ndërgjegjësuese për tre grupe interesi si fëmijët dhe të rinjtë, mësuesit, prindërit dhe punonjësit social si dhe subjekte të sektorit të industrisë. Gjatë workshop-it AKCESK prezantoi rezultatet e aktivitetet e zhvilluara për implementimin e këtij projekti në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pjesëmarrës ishin institucione shtetërore që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve si MAS, ASHDMF, AKEP, QPKMR, Policia e Shtetit, përfaqësues nga Ofruesit e Shërbimit të Internetit (ISP), gjithashtu dhe shumë organizata joqeveritare përfaqësues të shoqërisë civile, ku gjatë diskutimeve treguan punën e tyre të vazhdueshme në mbrojtje të fëmijëve, ngritën problematika në lidhje me boshllëqet ligjore dhe nevojën e legjislacionit në fuqi për ndryshim, si dhe u diskutua mbi urat e bashkëpunimit dhe krijimin e projekteve vazhdueshme në të ardhmen nëpërmjet institucione kompetente, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare partner si ITU.

Në këtë workshop u theksua rëndësia e ndërgjegjësimit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në internet, duke ofruar burime dhe mjete që mbështesin fëmijët, prindërit, mësuesit, edukatorët, punonjësit social, duke ndërmarrë masat e nevojshme për krijimin e një ekosistemi sa më të sigurt online.



“Politikat e Sigurisë Kibernetike dhe Menaxhimi i Krizës” për Institucionet e Pavaruara, Sektorin UK, AKSHI dhe Policinë e Shtetit.

Në vazhdim të objektivës së AKCESK për rritjen e kapaciteteve si një ndër shtyllat kryesore për mbrojtjen e infrastrukturave të informacionit me mbështetjen e partnerit tonë Risi Albania/Helvetas dhe kontributin e çmuar të ekspertëve të Autoritetit, zhvilloi në datat 20, 21 dhe 22 Dhjetor 2023, trajnimin e parashikuar me temë “Politikat e Sigurisë Kibernetike dhe Menaxhimi i Krizës” për Institucionet e Pavaruara, Sektorin UK, AKSHI dhe Policinë e Shtetit.

Për vetë rëndësinë që këta sektor kanë përsa i përket infrastrukturave të informacionit që ata administrojnë, gjatë këtij trajnimi tre ditor u bënë prezantime lidhur me kuadrin ligjor, strategjinë, politikat, masat e nevojshme të sigurisë që duhet të ndërmerren nga infrastrukturat e informacionit dhe nevojat për qeverisje kibernetike.

Pjesë e rëndësishme e këtij trajnimi ishte zhvillimin i tre skenarëve të ndryshëm TTX, për menaxhimin e incidentit kibernetik. Gjithashtu u zhvilluan 2 ditë stërvitje kibernetike (Cyber Drill) me ushtrime konkrete mbi menaxhimin e incidentit kibernetik, nëpërmjet platformës FISA.al.

Në përbushje të objektivave për të arritur standartet ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike, AKCESK do të vazhdojë të organizojë trajnime për të gjithë sektorët që administrojnë infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të informacionit me qëllim ndërtimin e një ekosistemi kibernetik të qëndrueshëm në Shqipëri.

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Dhjetor 2023

Përmbajtja:

- Microsoft paralajmëron se hakerat po shfrytëzojnë aplikacionet OAuth
- Aplikacioni i cili mundëson skanimin e Barkodeve në Android, ekspozon fjalëkalimet e përdoruesve
- Toyota - data breach
- Google - patching alert



Microsoft paralajmëron se hakerat po shfrytëzojnë aplikacionet OAuth

Ekipi i Microsoft Threat Intelligence paralajmëron se grupet e kimit kibernetik janë duke përdorur aplikacionet OAuth si një mjet automatizimi për të vendosur makina virtuale (VM) dhe për të nisur sulme phishing.

Për të zbutur rreziqet që lidhen me sulme të tilla, rekomandohet që organizatat të zbatojnë autentifikimin me shumë faktorë (MFA), të mundësojnë politikat e aksesit të kushtëzuar dhe të auditojnë në mënyrë rutinore aplikacionet dhe lejet e miratuara.

[Lexo më shumë](#)



Aplikacioni i cili mundëson skanimin e Barkodeve në Android, ekspozon fjalëkalimet e përdoruesve

Studiuesit e sigurisë kanë zbuluar së fundmi aplikacionin **Android Barcode to Sheet**, i cili rrjedh informacione të ndjeshme të përdoruesit dhe të ndërmarrjeve të ruajtura nga krijuesit e aplikacionit.

Ekipi i sigurisë zbuloi se zhvilluesit e aplikacionit kanë lënë bazën e të dhënave të tyre Firebase, që përmban mbi 368 MB të dhëna, të hapura për t'u aksesuar lehtësisht.

[Link: Lexo më shumë](#)



Toyota - data breach

Toyota ka paralajmëruar klientët se kanë pësuar një shkelje të të dhënave, duke deklaruar se të dhënat e ndjeshme personale dhe financiare janë ekspozuar gjatë sulmit.

Aktorët e kërcënimit kërkuan një pagesë prej 8,000,000 dollarë për të fshirë të dhënat e vjedhura dhe i dhanë Toyota-s 10 ditë për t'iu përgjigjur shantazhit të tyre.

Toyota premtan të përditësojë menjëherë klientët e prekur nëse hetimi i brendshëm zbulon ekspozim të mëtejshëm të të dhënave.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Google - patching alert

Google has released an emergency update to address a new zero-day vulnerability, identified as CVE-2023-7024, in the Chrome browser.

The vulnerability has been addressed with the release of version 120.0.6099.129 for Mac, Linux and 120.0.6099.129/130 for Windows, which will be released in the coming days/weeks.

[Read more](#)